

Cikli I programeve: “PERMES BIBLES”

Emisioni nr 1084 Zbulesa 13

FRONI I ZOTIT

Krishti shihet këtu në detyrën e Tij të trefishtë si profet, prift dhe mbret. Ai adhurohet si Zot, sepse është i tillë.

“Pas këtyre gjërave, pashë dhe ja, një derë u hap në qiell dhe zëri i parë që kisha dëgjuar të fliste me mua si bori, tha: “Ngjitu këtu dhe do të të tregoj gjërat që duhet të ndodhin pas këtyre gjërave.” [Zbl. 4:1].

Më poshtë do të shihni përkthimin tim për vargun e parë:

Pas këtyre gjërave [gr.:meta tauta] pashë një derë që u hap në qiell dhe zëri i parë që kisha dëgjuar të fliste me mua si bori, tha: ‘Eja këtu lart dhe do të tregoj gjërat që duhet të ndodhin pas këtyre gjërave. [meta tauta].’

Fraza “pas këtyre gjërave” (meta tauta) përdoret dy herë në këtë varg. Ajo e hap dhe e mbyll atë. Padyshim që përsëritja thekson rëndësinë e kësaj fraze. Sic duket, Gjoni kishte frikë se mos amilenialistët nuk do ta kuptonin këtë, kështu që e përdor dy herë në këtë pasazh.

“pashë” – këtu kemi të bëjmë me portën e syve. “dëgjova” – kjo është porta e veshit. Ky është një lloj si një program televiziv që shohim. Ky është programi i parë i madh televiziv. Në kohën tonë kemi pasur kënaqësinë e mrekullueshme të shohim një program televiziv nga hëna, por kjo nuk është asgjë krahasuar me programin televiziv nga qielli! Kjo duhet të zgjojë interesin tek besimtarët dhe nuk duhet t’i shtyjë të ngrihen si një fishekzjarr drejt ca ëndrrave të kota. Qielli është një vend i vërtetë. Në të ka shumë vërtetësi dhe ne nuk duhet të jemi në ankth për këtë skenë që shfaqet para nesh. Ne duhet ta trajtojmë atë në mënyrë normale, por e pranoj që nuk mund të rri pa u ngazëllyer për të.

“dhe ja, një derë u hap në qiell”. Kjo është një nga katër dyert e hapura në Librin e Zbulesës:

1. Në kapitullin 3, vargu 8, kur po i fliste kishës në Filadelfia, Zoti Jezus tha: “Kam vënë para teje një derë të hapur.” Kjo duket si një derë mundësie për të shpërndarë Fjalën e Zotit.

2. Dera e hapur e ftesës dhe identifikimit me Krishtin jepet në kapitullin 3, vargu 20: “Ja, unë qëndroj te dera dhe trokas; nëse dikush dëgjon zërin tim dhe të hapë derën, unë do të hyj tek ai dhe do të ha darkë me të dhe ai me mua.” Kjo është dera e zemrës tuaj.

3. Edhe në vargun 1 kemi një derë të hapur, që sic do ta shohim është rruga tek Perëndia nëpërmjet Krishtit.

4. Në kapitullin 19, vargu 11, shohim sërish një derë të hapur në qiell. Ajo është dera e hapur përmes së cilës Krishti do të vijë në ardhjen e Tij të dytë. Ai do të vijë në fund të periudhës së Mundimit të Madh për të hedhur poshtë të gjithë padrejtësinë dhe rrebelimin kundra Zotit dhe për të themeluar mbretërinë e Tij.

Gjoni nuk e sheh hapjen e derës të vargut 1 sic e jep përkthimi i Versionit të Autorizuar të Biblës. Kjo dorë ka qenë e hapur gjatë gjithë kohës. Ajo është dera përmes së cilës besimtarët kanë ardhur tek Perëndia përgjatë dymijë vjetëve. “Jezusi i tha: unë jam udha, e vërteta dhe jeta; askush nuk vjen tek Ati, përveçse nëpërmjet meje.” (Gjon. 14:6). Ai gjithashtu tha: “Unë jam dera; nëse dikush hyn nëpërmjet meje, do të shpëtohet; do të hyjë, do të dalë dhe do të gjejë kullotë.” (Gjon. 10:9). Dera e hapur për në qiell është Zoti Jezus Krisht. Ai do të vijë edhe në derën e zemrës tuaj. Kjo është mrekullia dhe lavdia e gjithçkaje.

Ne hyjmë në atë derë me anë të besimit. Në terminologjinë moderne, mund ta shprehim në këtë mënyrë: besimi na vendos në platformën e lëshimit të kishës, që është Krishti dhe në kohën e Rrëmbimit do të kalojmë përmes kësaj dera si një raketë e drejtuar. Kjo raketë nuk lëshohet në hapësirë për të shkuar ku të dojë, por ka një qëllim. Dhe nëse njeriu arriti të realizojë synimin e tij për të shkuar në hënë, mendoj që Zoti Jezus nuk do të ketë probleme për ta cuar kishën e Tij në qiell.

Fraza “Ngjitu këtu” është ftesa qiellore për Gjonin dhe për të gjithë ata që kanë miqësi me Krishtin dhe e njohin si Shpëtimtarin e tyre. Tek 1 Gjon. 1:3 thuhet: “Atë që pamë dhe dëgjuam, ne po jua shpallim, që edhe ju të keni bashkësi me ne; dhe bashkësia jonë është me Atin dhe me Birin e tij, Jezu Krishtin.”

Në fakt, Gjoni po thotë: “Ne e pamë, e dëgjuam dhe po ua shpallim edhe juve. Po ua bëj të ditur këtë në mënyrë që të keni miqësi me Atin dhe një ditë të ngjiteni dhe të kaloni përmes asaj dere të hapur.”

“zëri i parë që kisha dëgjuar të fliste me mua si bori” Ky është tingulli që thërret kishën për t’u takuar me Krishtin në ajër. Zëri i kujt është ai? Zëri i Krishtit. Kjo na prezanton me një nga simbolet më të thjeshta që do të shfaqet shpesh duke filluar nga ky kapitull. Fakti që ky është një simbol është shumë i qartë – një bori nuk flet. Të përkushtuarit e xhazit thonë se boritë e disa muzikantëve “flasin”. Kur ata që janë të dhënë pas xhazit thonë këto fjalë, përdorin vetëm një simbol. Një bori nuk flet. Zëri i Krishtit është si një bori dhe pikërisht këtë zë përshkroi Pali tek 1 Thesalonikasit 4:16-17: “sepse Zoti vetë, me një urdhër, me zë kryeengjelli dhe me borinë e Perëndisë, do të zbresë nga qielli dhe ata që vdiqën në Krishtin do të ringjallen të parët; pastaj ne të gjallët, që do të kemi mbetur, do të rrëmbehemi bashkë me ata mbi retë, për të dalë përpara Zotit në ajër; dhe kështu do të jemi përherë bashkë me Zotin.”

Kjo është një deklaratë e qartë në lidhje me Rrëmbimin. Fjala greke për rrëmbimin është *harpazo*, që do të thotë “të kapësh, të rrëmbehesh”. Hal Lindsei e quan Rrëmbimin “rrokja e madhe”. Mendoj se kjo është një gjuhë e mirë për të rinjtë, por personalisht preferoj termin “rrëmbehemi”. Nëse nuk ju pëlqen fjala rrëmbim, atëherë quheni *harpazo*. Pali përdori këtë fjalë. Ne do të rrëmbehemi në ajër dhe zëri i Zotit do të jetë si një bori. Ky zë e tërhoqi Gjonin lart dhe një ditë ai do të na tërheqë edhe ne lart.

“Ngjitu këtu dhe do të tregoj gjërat që duhet të ndodhin pas këtyre gjërave.” Pas kujt gjërave? Pas përfundimit të ecjes së kishës në tokë dhe rrëmbimit të saj.

“Dhe menjëherë erdha në frymë; dhe ja, një fron ishte në qiell dhe mbi fron rrinte një i ulur.” [Zbl. 4:2].

Menjëherë e gjeta veten në Frymë; dhe ja një fron ishte në qiell dhe mbi fron qëndronte një i ulur.

“Menjëherë” tregon shkurtësinë e kohës, që është një nga karakteristikat e Rrëmbimit. Pali thotë se ne do të rrëmbehemi “në një moment, sa hap e mbyll sytë” (shih 1 Kor. 15:51-52). Hapja dhe mbyllja e syve ndodh shumë shpejt. Një farë psikologu e mati atë kohë. Ai mori parasysh vetëm ngritjen e qepallës dhe jo uljen e saj

dhe arriti në përfundimin se bëhej në 1/1000 e sekondës. Ja, pra sa shpejt që do të ndodhë Rrëmbimi – menjëherë, aty për aty, befas.

“erdha në Frymë”. Pra, e thënë ndryshe, Fryma e Shenjtë po e drejton ende Gjonin në të vërteta të reja dhe po i tregon gjërat që do të vijnë (shih Gjon 16:13).

“dhe ja, një fron ishte në qiell dhe mbi fron rrinte një i ulur.” Froni ishte tashmë atje, por Gjoni e sheh për herë të parë. Vëmendja jonë drejtohet tani në qendrën e gjithçkaje. Froni përfaqson sovranitetin universal dhe sundimin e Perëndisë. Kjo do të thotë se Ai është në kontroll. Zyrat e përgjithshme të universit ndodhen në qiell dhe jo në Uashington D.C, Londër, Paris, apo ndonjë vend tjetër këtu poshtë. Kjo është pamja që na jepet në Fjalën e Zotit. Tek Psalmi 11:4 lexojmë: “Zoti është në tempullin e tij të shenjtë; Zoti ka fronin e tij në qiejtë; sytë e tij shohin, qepallat e tij vëzhgojnë bijtë e njerëzve.” (shih edhe Psa. 47:8, 97:2, 103:19, Ezek. 1:26-28). Ky është froni i Atit Perëndi dhe Jezusi ulet në anën e djathtë të Tij. Psalmi 110:1 na tregon: “Zoti i thotë Zotërisë tim: "Ulu në të djathtën time deri sa t'i bëj armiqtë e tu stol të këmbëve të tua.” (shih edhe Heb. 1:3; 12:2). Zoti Jezus i ka në kontroll të gjitha ngjarjet këtu.

Froni i hirit tani është kthyer në një fron gjykimi. Kjo është një arsye tjetër pse e them me siguri që kur të ndodhin këto gjëra kisha do të jetë larguar nga bota. Nëse kisha do të ishte ende në tokë, kur Krishti të ishte larguar nga vendi i ndërmjetësimit dhe të kishte shkuar në vendin e gjykimit, atëherë do të ishte në vendin e gabuar.

“Dhe ai që ishte ulur nga pamja i ngjante një guri diaspri dhe sardi; dhe rreth fronit ishte një ylber që i ngjante smeraldit.” [Zbl. 4:3].

Gjithcka që shohim është një ngjyrë e bukur si gurët e cmuar. Nuk shohim një pamje të Zotit. Ai nuk është fotografuar asnjëherë. Vëmendja jonë drejtohet tek Ai që është ulur në fron. Edhe pse është Ati Perëndi, ne duhet të kuptojmë se ky është froni i trinitetit të Perëndisë. Megjithatë, tre personat e trinitetit dallohen qartë: (1) Perëndia Frymë e Shenjtë në vargjet 2 dhe 5; (2) Perëndia At në vargun 3; dhe (3) Perëndia Bir në vargun 5 të kapitullit 5.

Ajo çfarë shohim përpara nesh është Triniteti mbi fron.

Gjoni nuk mund të dallojë asnjë formë personi mbi fron, vetëm shkëlqimin dhe ndricimin e gurëve të cmuar.

“ai që ishte ulur nga pamja i ngjante një guri diaspri”. Guri i diasprit ishte guri i fundit i identifikuar në parzmoren e kryepriftit (shih Eks. 28:20). Ai ishte i pari në themelet e Jeruzalemit të Ri dhe po kështu i pari në murin e Jeruzalemit të Ri (shih Zbl. 21:18-19). Ai ishte një gur shumëngjyrësh ku mbizotëronte ngjyra e purpurt. Disa e identifikojnë atë me një diamant. Ai ndodhej në parzmoren e kryepriftit të Izraelit, përfaqsonte Benxhiaminin e vogël, të cilin Jakobi e quajti “biri i krahut tim të djathtë”. Ndoshta kjo i referohet Krishtit, kur u ngjit dhe zuri vendin e Tij në anën e djathtë të Atit.

“Guri i sardit” është guri i gjashtë në themelin e Jeruzalemit të Ri (shih Zbl. 21:20). Plini thotë se ai u zbulua në Sardë dhe prej andej mori edhe emrin. Ngjyra e tij ishte e kuqe e zjarrtë. Guri i sardit ishte guri i parë në parzmoren e kryepriftit dhe përfaqsonte fisin e Rubenit, të parëlindurin e Jakobit. Krishti është Biri i Perëndisë, i parëlinduri nga të vdekurit.

“Ylber” është fjala greke *iris*, që do të thotë edhe “aureolë, ose kurorë drite”. Ndërkohë që ylberi është me shumë ngjyra, këtu shohim një smerald, që është në ngjyrë të gjelbër (shih Ezek. 1:28). Pas gjykimit të Përmbytjes, në tokë u shfaq ylberi si një kujtesë e beslidhjes së Zotit për të mos e shkatërruar tokën sërish me përmbytje (shih Zan. 9:13-15). Ylberi shfaqet sërish këtu para gjykimit të Mundimit të Madh për të kujtuar se përmbytja nuk do të përdoret në gjykim. E gjelbërta është ngjyra e tokës. Në këtë moment na kujtohen fjalët e Habakukut: “... në zemërim e sipër kujtoje mëshirën” (Hab. 3:2) – dhe Perëndia do ta bëjë këtë.

NJËZET E KATËR PLEQTË

“Dhe rreth e qark fronit ishin njëzet e katër frone, dhe mbi frone pashë ndenjor njëzet e katër pleq të veshur me petka të bardha; dhe mbi kryet e tyre kishin kurora.” [Zbl. 4:4].

Në lidhje me çështjen se kush janë këta pleq është spekuluar shumë. Fjala greke për “pleq” është *presbuteros*. Fjala presbiterian vjen prej saj dhe më kujton historinë e një vajze të vogël që u kthye në shtëpi nga shkolla e saj presbiteriane e së dielës dhe e ëma e pyeti se përse kishin folur atje. Vajza e vogël iu përgjigj: “Ne folëm për qiellin” Nëna e pyeti: “Epo, c’ thanë për të.” “Mësuesi tha se atje ishin vetëm 24 presbiterianë!” –ia ktheu vajza.

Në të vërtetë, pleqtë ishin përfaqësues. Ne e dimë se Izraeli kishte pleq dhe se ata caktoheshin në kishat e hershme për të rregulluar çështjet dhe për të përfaqësuar të gjithë kishën (Titi 1:5). Roli i tyre kuptohej fare mirë nga njerëzit në kohën e Gjonit. Këta njëzet e katër pleq përfaqsojnë të gjithë kishën që nga dita e Pentakostit e deri në kohën e Rrëmbimit. Prandaj, mund të them në mënyrë kategorike dhe të pakundërshtueshme se kjo është kisha në qiell.

Shprehja “petka të bardha” i referohet drejtësisë së Krishtit (shih 2 Kor. 5:21).

{Fraza “kurora” në anglisht është “kurora ari” shën. i përkthyesit.} Kurorat tregojnë se kisha do të mbretërojë me Krishtin (shih 1 Kor. 6:3). Kurorat do të jepen edhe si shpërblime (shih 2 Tim. 4:8; Jakobi 1:12; 1 Pjet. 5:4) kur të ndodhë gjykimi *bema*, gjykimi i Krishtit.

“dhe nga fronti shpërthenin vetëtima, bubullima dhe zëra; dhe përpara frontit ishin shtatë llamba të ndezura, që janë të shtatë Frymërat e Perëndisë.” [Zbl. 4:5].

Koha në këtë fjali është koha e tashme; ‘shpërthenin’ dhe jo ‘shpërthyen’. Vetëtimat dhe bubullimat po shpërthenin në atë moment.

“Vetëtima dhe bubullimat” gjithmonë i paraprijnë një stuhie dhe zakonisht tregojnë intensitetin e saj. Mendoj se kuptimi këtu është se gjykimi po vjen.

Fraza “dhe zëra” tregon se ky nuk është një gjykim kuturu, por që drejtohet nga Personi që është mbi fron.

Shprehja “shtatë Frymërat e Perëndisë” i referohet Frymës së Shenjtë.

KATËR QENIET E GJALLA

“Dhe përpara frontit ishte si një det i qelqtë që i ngjante kristalit, dhe në mes të frontit dhe përreth frontit katër kafshë, që ishin plot me sy përpara dhe prapa.” [Zbl. 4:6].

Shprehja “det i qelqtë” tregon pamjen e tij dhe jo materialin nga i cili përbëhet. Ky det ndodhet para frontit të Zotit dhe është një tjetër tregues që këtu nuk theksohet mëshira, por gjykimi. Ky det përfaqson shenjtërinë dhe drejtësinë e Zotit (shih Mt. 5:8; Heb. 12:14).

Tek 1 Thes. 3:13 thuhet: “për të bërë të patundura zemrat tuaja, pa të meta në shenjtëri përpara Perëndisë dhe Atit tonë, në ardhjen e

Perëndisë sonë Jezus Krisht bashkë me gjithë shenjtorët e tij. Amen.” Ky det i qetë tregon gjendjen shlodhëse të kishës. Ajo nuk është më viktimë e stuhive të jetës. Kisha nuk është më në mes të detit të trazuar.

“katër kafshët” janë në të vërtetë “katër krijesa të gjalla”. Fjala greke është *zoa*, nga e cila vjen edhe fjala zoologjik. Kjo fjalë nuk nënkupton një kafshë të egër. Ne do të shohim një kafshë të egër kur të arrijmë në kapitullin 13, por fjala që përdoret aty është një fjalë tjetër dhe një lloj tjetër kafshe. Ndërsa këtu bëhet fjalë vetëm për një krijesë të gjallë. Theksi nuk qëndron mbi anën e tyre kafshërore, por mbi anën vitale, mbi faktin që janë të gjalla.

“katër kafshë, që ishin plot me sy përpara dhe prapa”. Kjo shprehje simbolizon vigjilencën dhe një ndjenjë vetdijshmërie. Ato i përngjajnë si kerubinit të Ezekielit 1:5-10; 10:20, ashtu dhe serafimit të Isaias 6:2-3.

“Qenia e parë e gjallë ishte e ngjashme me një luan, qenia e dytë e gjallë e ngjashme me një viç, qenia e tretë e gjallë kishte fytyrë si të njeriut, edhe e katërta ishte e ngjashme me një shqiponjë në fluturim.” [Zbl. 4:7].

Jam dakort me ata studiues që identifikojnë secilën nga këto krijesa të gjalla me ungjillin që përfaqsojnë. Besoj se ky interpretim është i saktë edhe pse është diskutuar shumë.

“Qenia e parë e gjallë ishte e ngjashme me një luan” dhe ungjilli i parë përfaqson Zotin Jezus si Mbret. Ai lindi si Mbret, jetoi si Mbret, vdiq si i tillë, u ngall Mbret dhe do të vijë sërish si Mbret. Cdo gjë që bën në ungjillin e Mateut e bën si Mbret. Kujtoni se Zoti tha se fisi i Judës ishte si një luan, që Mbreti, Sunduesi do të dilte nga ai fis dhe se skeptri nuk do t’i hiqej Judës derisa të vinte Shilohu (shih Zan. 49:9-10; Zbl. 5:5).

“Qenia e dytë e gjallë e ngjashme me një viç” Kjo është një kafshë barre, një kafshë që shërben në shtëpi. Në ungjillin e Markut, Krishti prezantohet si Shërbëtori. Në këtë ungjill nuk jepet gjenealogjia e Tij. Nëse punësoni dikë për të kositur barin, apo për të larë enët, nuk e pyesni se nga i ka prindërit. Pse do t’ju duhej? Ju doni të dini vetëm nëse e bën, apo jo punën.

Ungjilli i Markut përfaqson Krishtin si Shërbëtor.

“Qenia e tretë e gjallë kishte fytyrë si të njeriut”. Ungjilli i tretë, ai i Lukës, përfaqson Zotin Jezus si Biri i Njeriut. Në të theksohet ana e Tij njerëzore.

“dhe e katërta ishte e ngjashme me një shqiponjë në fluturim”. Ai transmeton hyjninë e Krishtit, ashtu sic shihet në ungjillin e Gjonit.

Këto krijesa të gjalla përfaqsojnë edhe botën e kafshëve, sic sugjerohet nga Godet. Luani përfaqson kafshët e egra, vici kafshët shtëpiake, shqiponja përfaqson zogjtë dhe njeriu është kreu i të gjithë krijimit. Vini re se këtu nuk përmendet fare peshku. Në qiellin e ri dhe tokën e re, nuk do të ketë më det dhe meqënëse nuk do të ketë det, nuk do të ketë as peshq. Atje nuk do të ketë as zvarranikë. Gjarpëri nuk do të jetë atje për të paraqitur mëkatin sic bëri në fillim.

“Edhe të katër qeniet e gjalla kishin secila nga gjashtë krahë përçark, edhe përbrenda ishin plot me sy; dhe nuk pushojnë kurrë, as ditë as natë, duke thënë: ``I shenjtë, i shenjtë, i shenjtë është Zoti Perëndi, i Plotfuqishmi, që ishte, që është dhe që do të vijë!” [Zbl. 4:8].

Këto gjashtë krahë korrespondojnë me serafinin e Isaias 6:2.

Këtu përdoret sërish koha e tashme, gjë që do të thotë se veprimi po ndodh në atë moment.

Fjalët që thonë vazhdimisht janë: “I shenjtë, i shenjtë, i shenjtë është Zoti Perëndi, i Plotfuqishmi” Ky është i njëjti refren si ai i serafinit tek Isaia 6:3.

Shprehja “që ishte, që është dhe që do të vijë” i referohet Krishtit. Ai e identifikon Vetën që në fillim të këtij libri pikërisht kështu: “Unë jam Alfa dhe Omega, fillimi dhe mbarimi”, thotë Zoti “që është dhe që ishte dhe që vjen, i Plotfuqishmi.” (Zbl. 1:8).

Ai identifikohet për ne dhe për këtë arsye nuk kemi pse të hamendësojmë në vende të tilla.

“Sa herë që qeniet e gjalla i japin lavdi, nder e të falenderim atij që rri ulur mbi fron, atij që rron në shekuj të shekujve!

të njëzet e katër pleq bien përmbys përpara atij që rri mbi fron dhe adhurojnë atë që jeton në shekuj të shekujve dhe i hedhin kurorat e tyre përpara fronit, duke thënë

Ti je i denjë, o Zot, të marrësh lavdinë, nderimin dhe fuqinë, sepse ti i krijove të gjitha gjëra, dhe nëpërmjet vullnetit tënd ekzistojnë dhe u krijuan.” [Zbl. 4:9-11].

Kjo është skena e parë e madhe e adhurimit që shohim në qiell. Fraza “sa herë” tregon se ky është një akt i vazhdueshëm adhurimi. E thënë ndryshe, lavdërimi dhe admirimi janë aktivitete të përhershme të krijësave të Zotit në qiell. Krijimi adhuron Krijuesin si Zotin trini: “I shenjtë, i shenjtë, i shenjtë” Adhurimi është aktiviteti i qiellit.